



BIBLIOTEKA UAMD

PLANI STRATEGJIK 2020-2025

Përgatitur nga Venera Alliaj

biblioteka uamd

Biblioteka UAMD është e angazhuar për të ofruar shërbime cilësore për stafin, studentët dhe mbarë komunitetin përmes:

- 1 . një mjedisi të sigurtë dhe mikpritës që ofron hapësira të mjaftueshme dhe frymëzuese për nxitjen e të mësuarit , kërkimit dhe krijimtarisë ;
- 2 . stafit korrekt dhe të dobishëm , që krenohet me punën që bën në bibliotekë ;
- 3 . burimeve të informacionit lehtësisht të arritshme , të besueshme , dhe të një cilësie të lartë .

Për të arritur këtë biblioteka përpiqet vazhdimisht:

- 1 . të nxisë njohjen dhe përdorimin e koleksioneve dhe shërbimeve ;
- 2 . të nxisë angazhimin e gjithë anëtarëve të komunitetit universitar dhe atij qytetës ;
- 3 . të sigurojë hapësira krijuese ;
- 4 . të përqafojë kulturën e inovacionit dhe digjitalizimit .

**BIBLIOTEKA ËSHTË
ZEMRA E
UNIVERSITETIT**

parimet

Efektiviteti institucional

1. Biblioteka përcakton , mat dhe vlerëson efektivitetin institucional dhe përdor gjetjet për përmirësimin e saj të vazhdueshëm .

Vlerat profesionale

2. Biblioteka respekton vlerat e lirisë akademike dhe të drejtat e pronësisë intelektuale .

Roli edukativ

3. Biblioteka është ortakë besnike e misionit të institucionit , duke mbështetur dhe lehtësuar qasjen në informacion për suksesin akademik , kërkimin shkencor dhe të mësuarit e vazhdueshëm .

Zbulimi i së resë

4. Biblioteka siguron informacion në të gjitha formatet për të gjithë përdoruesit .

Koleksione të reja

5. Biblioteka siguron qasje në koleksione cilësore , në format të ndryshëm për mbështetjen e hulumtimit dhe mësimdhënies . **Hapësira fizike dhe digjitale**

6. Biblioteka është e plotë kur për lehtësimin dhe zgjerimin e njohurive , përdoruesit ndërveprojnë në dy mjedise , fizike dhe virtuale ,

Menaxhimi/administrimi

7. Biblioteka angazhohet në planifikimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm për përmbushjen e misionit në mënyrë efektive .

Personel cilësor

8. Biblioteka disponon personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për të përmbushur objektivat .

Marrëdhëniet me jashtë

9. Nëpërmjet bashkëpunimeve biblioteka mbron dhe promovon vlerat e saj brenda dhe jashtë institucionit .

QËLLIMI 1

AVANCIMI I IMPAKTIT RAJONAL DHE KOMBËTAR

Biblioteka UAMD , përmes aktiviteteve dhe promovimeve , nxitjes së krijimtarisë dhe inovacionit , do të kontribuojë në mënyrë aktive në mësimdhënie dhe kërkim shkencor për të përmirësuar ndikimin rajonal dhe kombëtar të vetë bibliotekës dhe universitetit

1.1 FORCIMI I BASHKËPUNIMIT DHE KËRKIMIT SHUMËDISIPLINOR

(1.1.1) Rezultate të prekshme nga mbështetja aktive e hulumtimit si: botime, blerje të reja, burime të hapura, përdorim i koleksioneve, etj. (1.1.2) Zhvillimi i partneriteteve afatgjata kërkimore duke iu dhënë përparësi trajnimeve,, workshop-eve, konsultave, etj.

1.3 FORCIMI I MBËSHTETJES PËR TË RRIJTUR IMPAKTIN INSTITUCIONAL DHE VIZIBILITETIN

(1.3.1) Demonstrimi i vlerave të bibliotekës dhe rritja e impaktit të saj përmes mbështetjes së hulumtimit të studimeve individuale, të një ekipi kërkimor, departamenti ose Fakulteti

(1.3.2) Pjesëmarrja e bibliotekës në takime, konsultime të niveleve të larta institucionale (siç është Senati Akademik).

1.2 FORCIMI I MËSIMDHËNIES DHE MËSIMNXËNIES

(1.2.1) Përmirësimi dhe zgjerimi i mundësive për të mësuarit eksperiencial (bazuar mbi përvojën) tek studentët.

(1.2.2) Zgjerimi i hulumtimit dhe i mundësive të zhvillimit profesional për studentët e diplomuar, lektorët dhe stafin administrativ.

(1.2.3) Sigurimi i qasjes në burime përmes përdorimit efektiv të teknologjisë

SYNIMET 5-VJEÇARE:

- Dyfishim i studentëve në mundësitë e të mësuarit që ofron biblioteka
- Pjesëmarrje e lartë e studentëve në shërbimet digjitale të bibliotekës
- Regjistrimi i studentëve në koleksione, burimet e hapura edukative, teknologji , etj. Rritja 50% e vizibilitetit të hulumtive individuale apo në rang departamenti/fakulteti.

QELIMI 2

OFRIMI I SHËRBIMEVE CILËSORE MBI BAZAT E DIVERSITETIT DHE GJITHËPËRFSHIRJES

Biblioteka UAMD zotohet të ndërtojë dhe ruajë një klimë të qëndrueshme të kujdesit , respektit dhe përgjegjësisë institucionale . Stafi i saj do të luajë rol aktiv në kapërcimin e të gjitha pengesave për gjithëpërfshirje në çështjet që lidhen me Bibliotekën .

• SYNIMET 5-VJEÇARE:

- Angazhimi i një individi që merret me përfshirjen dhe diversitetin brenda bibliotekave
- Dyfishim i pjesëmarrjes të komunitetit në programet, aktivitetet, workshop-et e organizuara nga biblioteka

2 . 1 Garantimi i gjithëpërfshirjes dhe diversitetit

(2 . 1 . 1) Krijimi i një strukture organizative efektive dhe përqafimi nga ana e personelit të vlerave dhe përgjegjësive që garantojnë arritjen e qëllimit të Bibliotekës për

gjithëpërfshirje dhe diversitet .

2 . 2 Rritja e përfshirjes, diversitetit dhe barazisë brenda bibliotekës

(2 . 2 . 1) Përmirësimi i praktikave , rekrutimit dhe zhvillimit profesional në Bibliotekë .

(2 . 2 . 2) Përmirësimi i klimës organizative të Bibliotekës bazuar mbi vlerat e edukimit , llogaridhënies dhe meritokracisë .

2 . 3 Mbështetja e gjithëpërfshirjes, diversitetit dhe barazisë në kampus dhe në komunitet

(2 . 3 . 1) Rritja e pjesëmarrjes dhe kontributit të Bibliotekës në advokimin e diversitetit në kampus dhe komunitet .

(2 . 3 . 2) Heqja e barrierave për qasje në burimet dhe shërbimet e Bibliotekës .

(2 . 3 . 3) Rritja e gjithëpërfshirjes dhe diversitetit të atyre që marrin pjesë në hulumtimet e lehtësuara nga Biblioteka , shkrim - këndimin digjital , angazhimit e komunitetit dhe mundësitë e punësimit .

QËLLIMI 3

TË QENIT NJË DESTINACION I TALENTIT

Biblioteka UAMD është një qendër bashkëpunimi dhe inovacioni , krijimtarie dhe përkujdesjeje . Ne aspirojmë të transformojmë mënyrën se si studentët përthithin njohuritë dhe bashkohen në një komunitet të larmishëm dhe gjithëpërfshirës për të qenë një forcë për ndryshime pozitive .

3.1 TËRHEQJA DHE ZHVILLIMI I NDËRSJELLË BIBLIOTEKË, STAF DHE STUDENTË

(3.1.1) Përmirësimi i praktikave dhe zhvillimit profesional bibliotekar. (3.1.2) Asistimi në zbulimin dhe zhvillimin e talentit brenda universitetit.

3.2 SIGURIMI I KOLEKSIONEVE TË BIBLIOTEKAVE, HAPËSIRAVE, MUNDËSIVE TË TË MËSUARIT DHE EKSPERTIZËS SHKENCORE PËR TËRHEQJEN DHE KULTIVIMIN E TALENTEVE PËR UNIVERSITETIN DHE MË GJERË

(3.2.1) Përmirësimi i vazhdueshëm i hapësirave, burimeve dhe shërbimeve të Bibliotekës. (3.2.2) Rritja e profilit të universitetit dhe shtimi i prurjeve të reja (në programe) përmes sukseseve të arritura në Bibliotekë.

(3.3.3) Apel studentëve aktualë dhe anëtarëve të komunitetit për qasje në burime digjitale, të mësuarit eksperiencial të ofruara nga biblioteka.

SYNIMET 5-VJEÇARE:

- Projekte të reja për rinovimin e bibliotekës
- Hapja e degëve (dhe hapësirave) të reja të bibliotekës nëpër fakultete

QELIMI 4

OFRIMI I SHËRBIMEVE CILËSORE MBI BAZAT E DIVERSITETIT DHE GJITHËPËRFSHIRJES

Biblioteka UAMD ka përqafuar vizionin e Shoqatës së Bibliotekave Shkencore që i zhvendos ato nga një ofrues i shërbimit të dijeve në një partner bashkëpunues. Sipas këtij vizioni, ne do të vazhdojmë të shërbejmë efektivisht në programet ekzistuese dhe të promovojmë bashkëpunime me aktorë lokalë, kombëtarë e ndërkombëtarë për të zhvilluar dhe përmirësuar rolin e Bibliotekës.

SYNIMET 5-VJEÇARE:

- 30% rritje e përdorimit të hapësirave të bibliotekës
- 30% rritje e përdorimit të koleksioneve të bibliotekës
- 30% rritje e përdorimit të librarisë, burimeve digjitale Vlerësim i nevojave dhe planifikimi për të ardhmen Vlerësimi dhe matja vjetore e performancës
- Rishikimi vjetor i koleksioneve

4.1 Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit organizativ

(4.1.1) Përfshirja e teknologjive që përmirësojnë qëndrueshmërinë, qasjen dhe përdorimin e koleksioneve të Bibliotekës.

(4.1.2) Identifikimi dhe mbyllja e zbrazëtie midis shërbimeve për burimet fizike dhe digjitale. Qasje të barabartë në këto burime për të gjithë komunitetin e UAMD - së, pavarësisht vendndodhjes.

(4.1.3) Përmirësimi dhe automatizimi i hapësirave fizike përmes projekteve të reja.

4.2 Forcimi i bashkëpunimeve dhe nismave strategjike

(4.2.1) Shtimi i memorandumeve që u mundësojnë specialistëve të Bibliotekës që të arrijnë qëllimet strategjike të Bibliotekës dhe universitetit.

(4.2.2) Zhvillimi i bashkëpunimit mes Fakulteteve dhe Bibliotekës, si dhe përfshirja e saj në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

4.3 Përmirësimi i proceseve dhe komunikimit

(4.3.1) Zhvillimi i një procesi gjithëpërfshirës për planifikim të vazhdueshëm strategjik. Rishikim periodik i procedurave të vlerësimit për shërbimet dhe projektet e Bibliotekës.

(4.3.2) Përsosja e komunikimit të brendshëm për të nxitur bashkëpunimin dhe ndërgjegjësimin për shërbimet dhe arritjet e Bibliotekës.



Biblioteka UAMD, është zemra e Universitetit.